VENDIM
Nr. 83, datë 28.1.2015
PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E *AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE* [1]
(Ndryshuar me VKM nr. 11, datë 12.1.2018)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", të nenit 6, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të nenit 15, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Shtetit për Çështjet Vendore, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e *Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore* , më poshtë *agjencia* , si institucion publik qendror, person juridik, me seli në Tiranë, *në varësi të ministrit përgjegjës për çështjet vendore*, që financohet nga buxheti i shtetit dhe të ardhura të tjera të ligjshme.

2. *Agjencia* ka si mision dhënien e ndihmës për garantimin e vazhdueshmërisë së funksioneve dhe shërbimeve publike, në nivel vendor, në kuadër të zbatimit të reformës administrativo-territoriale.

3. *Agjencia* ka si qëllim mundësimin e zbatimit të reformës administrativo-territoriale, nëpërmjet bashkërendimit të të gjitha masave, proceseve dhe mbështetjes administrative deri në arritjen e funksionalitetit të plotë të 61 bashkive të reja.

4. *Agjencia ka këto detyra dhe përgjegjësi:*

a) Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore në koordinimin e punës për zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e decentralizimit dhe qeverisjes vendore;

b) Monitoron zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020, si dhe planit të veprimit përkatës;

c) Informon periodikisht institucionet publike, grupet e interesit dhe qytetarët mbi çështjet që lidhen me qeverisjen vendore;

ç) Bashkëpunon me strukturën përkatëse të ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore për propozimin dhe përmirësimin e akteve ligjore e nënligjore në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore, 2015–2020;

d) Mbështet ministrin përgjegjës për çështjet vendore për krijimin dhe administrimin e një sistemi kombëtar unik, me synim zbatimin e funksioneve të deleguara të vetëqeverisjes vendore;

dh) Siguron informacione lidhur me çështjet e vetëqeverisjes vendore, me qëllim koordinimin e institucioneve publike qendrore e vendore dhe harton raporte, analiza periodike mbi këto çështje;

e) Ofron këshillim ligjor dhe teknik për njësitë e vetëqeverisjes vendore në procesin e ushtrimit të funksioneve të tyre;

ë) Shërben si qendër e evidentimit dhe e promovimit të praktikave më të mira dhe/ose modeleve rekomanduese për çështjet e vetëqeverisjes vendore;

f) Bashkërendon me strukturën përkatëse të ministrisë përgjegjëse për çështjet vendore për përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin në kuadër të procesit të integrimit në Bashkimin Evropian dhe të marrëveshjeve ndërkombëtare;

g) Mbështet ministrinë përgjegjëse për çështjet vendore (në rolin e një sekretariati teknik) në koordinimin e punës me organizmat dhe partnerët ndërkombëtarë që mbështesin zhvillimin e njësive të vetëqeverisjes vendore;

gj)Raporton periodikisht pranë ministrit përgjegjës për çështjet vendore mbi veprimtarinë e saj dhe për realizimin e detyrave e të përgjegjësive të përcaktuara në këtë vendim.

5. *Organika dhe struktura e Agjencisë miratohen me urdhër të Kryeministrit, sipas legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore.*

---

[1] *VKM nr.83, datë 28.1.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.14, 10 shkurt 2015.*
VKM nr.11, datë 12.1.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.3, 18 janar 2018.

6. *Agjencia* drejtohet nga drejtori i Përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie.

7. *Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë emërohet, lirohet ose shkarkohet me urdhër të ministrit përgjegjës për çështjet vendore.*

8. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të kësaj agjencie rregullohen me Kodin e Punës. Ata emërohen, lirohen ose shkarkohen nga drejtori i Përgjithshëm, me miratimin e *ministrit përgjegjës për çështjet vendore.*

9. Ngarkohen Kryeministria, *ministri përgjegjës për çështjet vendore* dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama